



**Partia Demokratike e Kosovës  
(PDK)**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2019**

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme .....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10 - 14

# Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Opinion

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik "Partia Demokratike e Kosovës" (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "PDK"), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2019, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë date, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 7-14

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2019, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

### Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin tonë ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik në bletjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedurë të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik edhe pse e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm, nuk e ka ushtruar një kontroll të tillë.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin

e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

- Pasqyrat Financiare te SP nuk janë të nënshkruara në harmoni me : Ligjin Nr. 06/L- 032, Për Kontabilitetet, Raportim Financiar dhe Auditimi ; dhe me UA MF-NR. 07/2019 Neni 8 ; Nënshkrimi i pasqyrave financiare ; Pika 2. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i certifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i certifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje

me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

  
Ymer Shatri  
Auditor Ligjor  
30 Shtator 2021



## Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2019	Me 31 Dhjetor 2018
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	45,445.68	31,005.63
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>45,445.68</b>	<b>31,005.63</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		5,442.08	2,632.11
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	16,155.89	24,306.44
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>18,788.00</b>	<b>26,938.55</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>67,043.65</b>	<b>57,944.17</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		(463,036.32)	(790,120.44)
Suficiti / (deficiti) i vitit		(78,662.60)	327,084.12
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>(541,698.92)</b>	<b>(463,036.32)</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra	5	45,445.68	31,005.62
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>45,445.68</b>	<b>31,005.62</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	505,707.95	463,843.43
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	57,558.94	26,131.44
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>563,296.89</b>	<b>489,974.87</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>608,742.57</b>	<b>520,980.49</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>67,043.65</b>	<b>57,944.17</b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2019	2018
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		1,163,159.50	1,228,500.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	35,897.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	520.00	
Të hyrat e fushatës		53,521.36	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyra	5	7,587.95	10,208.59
Të hyrat tjera			92.28
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>1,260,685.81</b>	<b>1,238,800.87</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	419,104.61	299,522.81
Shpenzimet e transportit	2	2,488.91	10,772.74
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	43,423.93	9,390.61
Shpenzimet e fushatës	2	316,966.37	
Blerja e mallrave	2	5,142.35	3,761.87
Shpenzimet e përgjithshme	2	65,044.57	75,232.20
Shpenzimet e ndryshme	2	487,177.67	513,036.52
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>1,339,348.41</b>	<b>911,716.75</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>(78,662.60)</b>	<b>327,084.12</b>

## 1. Informata te përgjithshme

### **Partia Demokratike e Kosovës PDK**

Partia Demokratike e Kosovës është themeluar më datën 12.10.1999.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës për vitin 2019 është : z. Kadri Veseli

Sekretari i përgjithshëm : Z. Batri Musmurati

Zyrtar financiar : Safete Hadergjonaj

Pasqyrat financiare te Partisë Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën NLB



**Shënimi 2. Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	363,875.89	363,875.89	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	19,011.00	18,135.50	875.50
Kontributet pensionale të punëdhënësit	19,011.00	18,135.50	875.50
Tatimet në të ardhura personale	17,206.72	16,804.79	401.93
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>419,104.61</b>	<b>416,951.68</b>	<b>2,152.93</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	10.00	10.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	2,478.91		2,478.91
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>2,488.91</b>	<b>10.00</b>	<b>2,478.91</b>
<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali	3,208.92		3,208.92
Ushqimi	39,915.01		39,915.01
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	300.00		300.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>43,423.93</b>	<b>0.00</b>	<b>43,423.93</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			

## Partia Demokratike e Kosovës

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor, 2019

Shpenzimet e fushatës	316,966.37	129,537.43	187,428.94
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>316,966.37</b>	<b>129,537.43</b>	<b>187,428.94</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	5,038.52		5,038.52
Pajisjet të vogla	103.83		103.83
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>5,142.35</b>	<b>0.00</b>	<b>5,142.35</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	45,025.43		45,025.43
Telefoni, interneti dhe posta	672.23	583.51	88.72
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	11,238.96	9,747.87	1,491.09
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	7,587.95	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	520.00	////////////////////	////////////////////
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>65,044.57</b>	<b>10,331.38</b>	<b>46,605.24</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	5,236.77	5,236.77	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	481,940.90	458,465.77	23,475.13
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>487,177.67</b>	<b>463,702.54</b>	<b>23,475.13</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>1,339,348.41</b>	<b>1,020,533.03</b>	<b>310,707.43</b>

## Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Shafi Gashi			2/8/2019	1,000.00	1,000.00	
Nuri Bexheti			2/8/2019	1,000.00	1,000.00	
Muhamet Morina			3/21/2019	1,000.00	1,000.00	
Fitim Polloshka			3/21/2019	999.00	999.00	
Fexhrie Luta			3/21/2019	900.00	900.00	
Alije Bunjaku			3/21/2019	1,000.00	1,000.00	
Muhamet Morina			3/21/2019	800.00	800.00	
Arsim Ajeti			3/21/2019	1,000.00	1,000.00	
Besnik Shaqiri			3/21/2019	1,000.00	1,000.00	
Behar Sekiraqa			3/21/2019	999.00	999.00	
Sami Ismjali			3/21/2019	999.00	999.00	
Blerand Stavileci			3/22/2019	1,000.00	1,000.00	
Abelard Tahiraj			3/22/2019	1,000.00	1,000.00	
Arben Gecaj			3/22/2019	1,000.00	1,000.00	
Ferid Pula			3/22/2019	1,000.00	1,000.00	
Gjobat Pzap Deputetet		Regjistri	Specifikacioni	20,200.00	8,300.00	11,900.00
Bujar Cakolli			3/22/2019	1,000.00	1,000.00	
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				<b>35,897.00</b>	<b>23,997.00</b>	<b>11,900.00</b>

## Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		në euro
Pagesë Zyrës Lipjan	Njazi Peja			5/11/2019	520.00
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>520.00</b>

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat	107,381.20	21,100.00	107,381.20	703.33	<b>20,396.67</b>
Pajisjet e zyrës	64,525.21		60,630.85	2,077.10	<b>1,817.26</b>
Pajisjet e teknologjisë informative	86,435.70		74,530.43	4,693.15	<b>7,212.12</b>
Pajisjet tjera	22,555.37	928.00	7,349.37	114.37	<b>16,019.63</b>
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>280,897.48</b>	<b>22,028.00</b>	<b>249,891.85</b>	<b>7,587.95</b>	<b>45,445.68</b>

**Shënime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Ip Magazin	600.00	600.00
Kosova Press	2,032.11	2,032.11
Kërkesa tjera-ATK	2,809.97	
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	<b>5,442.08</b>	<b>2,632.11</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	16,017.06	24,306.32
Paraja në arkë	138.83	0.12
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>16,155.89</b>	<b>24,306.44</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Furnitori 1 - regjistri	505,707.95	463,843.43
Furnitori 1		
Furnitori 1		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>505,707.95</b>	<b>463,843.43</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime	2,152.93	2,080.99
Detyrimet për qira	335.99	321.16
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	55,100.00	
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		23,729.29
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>57,588.94</b>	<b>26,131.44</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro**

Qëllimi i pagesës	Paguuar ndaj:			Numri personal	Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa				
Partner I Koalicionit	AAK	Prishtinë			Specifikacioni	286,125.00
Partner I Koalicionit	Nisma	Prishtinë			Specifikacioni	171,675.00
Realizimi Teknik I Fushatës	D-Line	Prishtinë			Specifikacioni	105,000.00
Gjobat	PZAP	Prishtinë			Specifikacioni	45,000.00
Marrëveshja	ATK	Prishtinë			Specifikacioni	40,797.01
Reklama TV	RTK	Prishtinë			Specifikacioni	24,124.00
Blerja e Veturës	Brikenë Haxhiu	Prishtinë			Specifikacioni	21,100.00
Energjia Elektrike	Kesko	Prishtinë			Specifikacioni	14,570.72
Zyra	Komuna Drenas	Prishtinë			Specifikacioni	13,929.72
Reklama Tv	Tv-Dukagjini	Prishtinë			Specifikacioni	12,675.00
Furnizim Bufeje	Tora Dpt	Prishtinë			Specifikacioni	9,475.00
Pajisje Teknologjike	Comtrade Computers	Prishtinë			Specifikacioni	6,613.00
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>						<b>751,084.45</b>